




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 15.09.2021

Kuvendi i Komunës pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 610, të datës 31.08.2021, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më datë 09.09.2021, të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafiu 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (s), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12. 1, shkronja (nj), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për miratimin në parim të Projekt-dokumentit për Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban të Fushë-Kosovës

1. Për miratimin në parim të Projekt-dokumentit për Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban të Fushë-Kosovës (PMQU).
2. Plani i mobilitetit të qëndrueshëm urban i Komunës së Fushë-Kosovës i cekur në pikën një të këtij vendimi, ka për qëllim krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të transportit urban.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i mobilitetit të qëndrueshëm urban i Fushë-Kosovës, me pjesën tekstuale dhe grafike.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKTORIJA ADMINISTRACIJE

Relaq/Restr. 142
Data/Datum 29-09-2021
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 27.09.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 23.09.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1103, të datës 22.09.2021, paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në lidhje me kërkesën Nr. 06-580/02-0028845/21, të datës 17.09.2021 nga pala Agim Bërbatovci, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 41, paragrafi 16, nenin 43, paragrafi 7, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, nenin 13, paragrafi 3, të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 83, të datës 14.06.2013, mori:

VENDIM

Për aprovimin e propozimit për lejinin e mjeteve financiare për shërim

1. Për aprovimin e propozimit për lejinin e mjeteve financiare në shumë prej 5,000.00€, për palën Agim Bërbatovci nga Fushë-Kosova, me destinim për të ndihmuar në shërimin shëndetësorë dhe trajtimin e tij, i cili vuan nga sëmundja me diagnozë Dg: Infiltrating Urothelial Carcinoma, high-grade Carinoma Metastaticum in lyphonodrum (4/6) Hyperplasia benibna prostate (BHP).
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për sigurimin e mjeteve financiare, për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHMS, Palës dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha

[Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 27.09.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 23.09.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1076, të datës 16.09.2021, paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 9, nenin 12, nenin 20, të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 06/L-005, (Gazeta Zyrtare, e datës 26 janar 2018), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 32, paragrafi 1, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, mori:

V E N D I M

Për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022

Neni 1

Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi i Komunës së Fushë Kosovës cakton normat tatimore për vitin 2022, për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronës publike, si vijon:

- Për njësiti bujqësore të parcelave----- (0.15%)
- Për njësiti bujqësore të objekteve----- (0.15%)
- Për njësiti pyjore të parcelave----- (0.15%)
- Për njësiti rezidenciale të parcelave----- (0.15%)
- Për njësiti rezidenciale të objekteve----- (0.15%)
- Për njësiti komerciale të parcelave----- (0.15%)
- Për njësiti komerciale të objekteve----- (0.22%)
- Për njësiti industriale të parcelave----- (0.15%)
- Për njësiti industriale të objekteve----- (0.15%)

Neni 2

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Zhvillim Ekonomik - Sektori për Tatim në Pronë.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.


Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së ZHE dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA-KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 12.10.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 08.10.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1139, të datës 29.09.2021, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç), nenin 54 të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


Për rritjen e të hyrave vetjake në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2021

1. Për rritjen e të hyrave vetjake për vitin fiskal 2021, në shumën e mjeteve financiare prej: 2,280,000.00€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike të pagave e shtesave, mallrave e shërbimeve, subvencioneve e transfereve dhe investime kapitale nëpër kodet e programeve, nënprogrameve dhe projekteve.
2. Mjetet financiare në shumë prej: 29,689.88€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa - 11, në dy kode të programeve në arsim për pagesën e mësimi jo formal si vijon:
 - 2.1 Shkolla e Mesme Teknike 'Minatori', programi 94231, shuma e mjeteve financiare prej: 11,135.28€ dhe
 - 2.2 Shkollën e Mesme Ekonomike 'Hoxhë Kadri Prishtina' - Fushë-Kosovë, programi 94232, shuma e mjeteve financiare prej: 18,554.60€.
3. Mjetet financiare në shumë prej: 900,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime - 13, në dy kode të programeve, në kujdesin primarë shëndetësorë për pagesën e personave të prekur me Coronavirusin Covid - 19 dhe Administratën e arsimit si vijon:
 - 3.1 Në kujdesin primarë shëndetësorë për pagesën e personave të prekur me Coronavirusin Covid - 19, programi 73150, shuma e mjeteve financiare prej: 600,000.00€ dhe
 - 3.2 Në Administratën e Arsimit, programi 92010, shuma e mjeteve financiare prej: 300,000.00€.
4. Mjetet financiare në shumë prej: 450,310.12€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere - 20, në katër kode të programeve.
 - 4.1 Për Zyrën e Kryetarit të Komunës, programi 16002, shuma e mjeteve financiare prej: 30,000.00€;
 - 4.2 Në Administratën e Shëndetësisë, programi 73011, shuma e mjeteve financiare prej: 170,310.12€;
 - 4.3 Për Kulturë, Rini dhe Sport, programi 85002, shuma e mjeteve financiare prej: 50,000.00€ dhe

- 4.4 Në Administratën e Arsimit, programi 92010, shuma e mjeteve financiare prej: 200,000.00€.
5. Mjetet financiare në shumë prej: 900,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike investime kapitale - 30, në dy kode të projekteve.
- 5.1 Për Kulturë, Rini dhe Sport, programi 85002, shuma e mjeteve financiare prej: 600,000.00€, për realizimin e projektit për ndërtimin e Palestrës Sportive në fshatin Sllatinë e Vogël dhe
- 5.2 Në Administratën e Arsimit, programi 92010, shuma e mjeteve financiare prej: 300,000.00€, për realizimin e projektit 44933, për ndërtimin e shkollës fillore në Fushë-Kosovë.
6. Mjetet financiare në shumë të përgjithshme prej: 2,280,000.00€ nga paragrafi 1, të zbërthyera në paragrafin 2, nënparagrafet 2.1 dhe 2.2, paragrafin 3, nënparagrafet 3.1 dhe 3.2, paragrafin 4, nënparagrafet 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4, paragrafin 5, nënparagrafet 5.1 dhe 5.2 të këtij vendimi lejohen për mbulimin e shpenzimeve për pagesat si vijon: mësimin jo formal për arsimtarët dhe stafin arsimorë, personat e prekur me sëmundjen ngjitëse infektive të Cornovirusit Covid - 19, shërbimet tjera kontraktuale për mbarrëvajtje të procesit mësimorë, subvencionimin e Organizatave Jo Qeveritare, ndihmë qytetarëve për shërim dhe trajtim shëndetësorë, ndihmë - bursa për studentët, ndihmë klubeve sportive dhe Organizatave tjera Jo Qeveritare në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, si dhe realizimin e investimeve në projekte kapitale për ndërtimin e Shkollës Fillore në Fushë-Kosovë dhe Palestrës Sportive në fshatin Sllatinë e Vogël.
7. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
8. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së FB, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës.**

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 14.10.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 08.10.2021, pas shqyrtimit urgjentë të rastit të fëmiut Noar Jahiri, që gjindet në shërim jashtë vendit, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës me datën 08.10.2021 shqyrtoi Propozimin për ndihmë financiare në shërim dhe trajtim shëndetësorë, si dhe evidentimit të kërkesës, Nr. 06-580/02-0031282/21, të datës 12.10.2021, të parashtruar nga pala Shpresa Qyqalla Jahiri për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 41, paragrafi 16, nenin 43, paragrafi 7, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, nenin 13, paragrafi 3, të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 83, të datës 14.06.2013, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e propozimit për lejimin e mjeteve financiare për shërim

1. Për aprovimin e propozimit për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 5,000.00€, për palën Shpresa Qyqalla Jahiri, me vendlindje në fshatin Bardh i Madh të Fushë-Kosovës, me destinim për të ndihmuar në shërimin shëndetësorë dhe trajtimin e djalit të saj Noar Jahiri, i cila vuan nga sëmundja me diagnozë Dg: Atrofi Progressive Parenkimale Amaurosis Epi.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për sigurimin e mjeteve financiare, për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHMS, Palës dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha